

# Popullsia e Shqipërisë

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadata Referenciale

1. Kontakt .....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore .....	2
4. Njësia matëse .....	3
5. Periudha e referencës .....	3
6. Mandati institucional.....	3
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit.....	4
9. Shpeshësia e shpërndarjes .....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	5
11. Menaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia .....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria .....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	9
15. Koherenca dhe krahasueshmëria .....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor .....	11
19. Komente .....	11
Aneks .....	11

<b>1.Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Popullsisë
1.3. Personi i kontaktit	Olta Caca
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Head of Population Statistics Sector
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri , ZIP Code, 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:ocaca@instat.gov.al">ocaca@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / 240
1.8. Numri i faksit	+355 (4 ) 228 300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	26.03.2020
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	18.02.2019
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	26.03.2020
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Përlllogaritjet e popullsisë më 1 Janar kryhen çdo vit nga INSTAT. Ato i referohen “popullsisë banuese”, duke përfshirë çdo banues në territorin e Shqipërisë gjatë periudhës referencë (dy 1 janareve të viteve të njëpasnjëshëm) pavarësisht shtetësisë së tyre. Popullsia banuese konsideron migrantët ndërkombëtarë (njerëzit që ndryshojnë shtetin e tyre të vendbanimit për një periudhë më shumë se 12 muaj) duke i shtuar numrit të popullsisë imigrantët apo të kthyerit që plotësojnë kushtin e vendbanuesit të zakonshëm dhe duke i zbritur numrin e emigrantëve, personave që largohen nga vendi për më shumë se një vit. Nga ana tjetër, popullsia e përlllogaritur nuk merr në konsideratë migrantët afat-shkurtër (njerëzit që vijnë apo largohen nga vendi për më pak se 12 muaj). Popullsia banuese disagregohet sipas moshës dhe gjinisë, si dhe sipas qarqeve. Popullsia mesatare: është numri i banorëve në një zonë të cakuar në mesnatën e 30 Qershorit dhe 1 Korrikut të një viti të caktuar. Popullsia mesatare përdoret si bazë për llogaritjen e indikatorëve demografik, por edhe atyre social edhe ekonomik.</p>

3.2. Sistemi i klasifikimit	Përlogaritjet e popullsisë banuese më 1 Janar të çdo viti janë konsistente me definicionin standart të UN për vlerësimin e popullsisë, i cili bazohet në konceptin e vendbanimit të zakonshëm. Sipas këtij definicioni përfshihen në popullsinë banuese të një viti, të gjithë ata persona që banojnë ose kanë si qëllim të banojnë në vend për të paktën 12 muaj, pavarësisht shtetësisë së tyre.
3.3. Mbulimi i sektorit	Përlogaritjet e popullsisë më 1 Janar mbulojnë gjithë territorin e Shqipërisë, disagregohen gjithashtu edhe sipas ndarjes administrative, të 12 qarqeve.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b>Vendbanues i zakonshëm:</b> quhen vendbanues të zakonshëm të gjithë personat pavarësisht shtetësisë së tyre, të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për të paktën 12 muaj ose që kanë qëllim për të qëndruar të paktën një vit.</p> <p><b>Popullsia mesatare:</b> është numri i banorëve në një zonë të caktuar në mesnatën e 30 Qershorit dhe 1 Korrikut të një viti të caktuar.</p> <p><b>Piramida e Popullsisë:</b> Është një lloj i veçantë grafiku bar që tregon përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe seksit.</p> <p><b>Projeksionet e Popullsisë:</b> Janë llogaritje të ndryshimeve të ardhshme në numrin e popullsisë, pasi janë bërë supozime rreth tendencave të ardhshme në koeficientet e lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është individi.
3.6. Popullata statistikore	Popullsia banuese e Shqipërisë më 1 Janar 2020.
3.7. Zona e referencës	Territori i Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Seritë kohore të popullsisë banuese në Shqipëri publikohen çdo vit, nga viti 2001 - 2020.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Invididët.
5. Periudha e referencës	Vjetore.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për prodhimin e treguesve të Popullsisë, është pjesë e bazës ligjore të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021</a></li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Aktualisht nuk ka shkëmbim të dhënash në nivel Evropian.
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga njësitë statistikore konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënat e mbledhura nga, apo tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore që i kanë ofruar të dhënat në fjalë për arsye dhe qëllime statistikore, apo të dhëna të vjela nga burime të tjera administrative. INSTAT ndërmerr tërë masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i statistikave vetëm në rast se:</p> <p>a) këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor;</p> <p>b) njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave. Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i Institutit të statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërdahet dhe të bëhet publike nga Instituti i statistikave, me qëllim që të bëhet i pamundur identifikimi i njësisë statistikore nga këto të dhëna.</p>
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.

8.2. Akses në kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendari</a> i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – online release;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. Publikimi;</li> <li>4. <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol>
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Popullsia banuese në Shqipëri më 1 Janar publikohet një herë në vit.
<b>10. Akses në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, të dhënat e Popullsisë banuese në Shqipëri, 1 Janar shpërndahen çdo vit me një publikim më vete, në data specifike, afërsisht 45 ditë pas datës së referencës, 1 Janarit të vitit korrent. Publikimi mundësohet në faqen zyrtare të INSTAT, në bazën e të dhënave statistikore Pxweb, gjithashtu shpërndahen elektronikisht tek përdoruesit.
10.2. Publikime	<p>Të dhënat publikohen në faqen zyrtare të INSTAT sipas rregulloreve dhe ligjit referues:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Publikimi Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar</a></li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi Statistikat e Popullsisë publikohen në faqen zyrtare të INSTAT: <a href="#">Databaza statistikore</a>
10.4. Akses në të dhënat mikro	Të dhënat mikro nuk janë publike për përdoruesin.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kontakt</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	<p>Përlllogaritjet vjetore të popullsisë bazohen në metodën e komponentit të gjeneratës. Kjo është një metodë standarde demografike, e cila përdor një sërë burime të dhënash për komponentët bazë të ndryshimit të popullsisë. Komponentët kryesorë të ndryshimit të popullsisë janë përmbledhur si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Shtesa Natyrore (lindjet dhe vdekjet)</b>- Si pikënisje për përlllogaritjen e popullsisë banuese u konsiderua numri i popullsisë banuese që më 1 Janar të vitit të mëparshëm. Kjo popullsi është rritur me një vit. Lindjet gjatë periudhës 12 mujore i janë shtuar popullsisë sipas gjinisë, ndërsa vdekjet janë zbritur</li> </ol>

respektivisht sipas moshës dhe gjinisë dhe sipas zonës së banimit në rastin tonë (qarkut)

### 1.1 Lindjet

*Ndryshimi në popullsi si pasojë e lindjeve:* Lindjet e gjalla që ndodhin nga 1 Janari në 31 Dhjetor të vitit të kaluar, i shtohen popullsisë zero vjeç sipas gjinisë dhe i shpërndahen qarkut ku lindja është regjistruar në zyrën e gjendjes civile.

*Të dhënat e lindjeve:* Të dhënat e lindjeve, sipas gjinisë sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ishvendbanimeve të tyre.

*Regjistrimet e vona të lindjeve:* Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i lindjeve të regjistruara vonë, në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

### 1.2 Vdekjet

*Ndryshimet në popullsi si pasojë e numrit të vdekjeve:* Vdekjet e regjistruara në Shqipëri nga 1 Janari në 31 Dhjetor të vitit të kaluar, i zbriten popullsisë sipas gjinisë dhe moshës dhe qarkut të vendbanimit.

*Të dhënat e vdekjeve:* Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, sipas karakteristikave bazë demografike. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

*Regjistrimet e vona të vdekjeve:* Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i vdekjeve të regjistruara vonë, në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

## 2. Lëvizjet e brendshme

Lëvizjet e popullsisë brenda territorit të vendit, gjithashtu sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile e cila i mundëson këto të dhëna në bazë vjetore. Përfshihen të gjitha lëvizjet e popullsisë të cilat janë shoqëruar me ndryshim të vendbanimit (qarkut) pasqyruar me regjistrim në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të ri të personit. Lëvizjet e brendshme të personave të cilat nuk janë shoqëruar me regjistrim në zyrat e gjendjes civile respektive sipas vendbanimit të ri, nuk mund të merren parasysh.

	<p><b>3. Migracioni Neto</b></p> <p>Lëvizjet e njerëzve që hyjnë dhe dalin nga vendi (migracioni ndërkombëtar), është komponenti më i vështirë për t'u matur, duke qenë se Shqipëria nuk ka ende një regjistër popullsisë. Në këtë mënyrë ne përdorim të dhënat më të mira "proxy" për vlerësimin e migracionit, duke u bazuar kryesisht në të dhënat e mbledhura nga moduli i migracionit nëpërmjet anketës së forcave të punës kombinuar me koeficientët e projeksioneve të popullsisë 2011-2031.</p> <p>Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodologji</a> për llogaritjet vjetore të popullsisë.</p>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Popullsisë dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e Statistikave të Popullsisë për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës (kostos) së të intervistuarve. Kontrollat e cilësisë dhe vleftësimi i të dhënave janë veprime që kryen përgjatë tërë procesit. Stafit i përfshirë në fazën e ndryshme të përpilimit të indeksit, - të këtilla si mbledhja e të dhënave, kontrollat fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollat përfundimtare që shoqërojnë përlllogaritjen e indeksit, - është i mirë trajnuar dhe me përvojën e duhur. Kjo i jep mundësinë stafit që të përftojë një pamje të plotë dhe në vijimësi rreth ndërmarrjeve dhe përgjegjësi të tyre.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Përlllogaritjet e popullsisë prodhohen duke u bazuar në një metodë demografike të mirë themeluar e quajtur, Metoda e Komponentit të Gjeneratës. Kjo përfshin kombinimin e informacionit nga një sërë burim të dhënash duke përfshirë Censusin e fundit, të dhëna administrative dhe të dhëna nga anketa të ndryshme sociale. Burimet e të dhënave të përdorura janë më të mirat e mundshme në nivel kombëtar dhe rajonal (qarku). Informacioni nga regjistrat administrativë si numri i lindjeve dhe vdekjeve dhe lëvizjet e brendshme konsiderohen të jenë shumë të besueshme dhe gjithëpërfshirëse.</p>
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përlllogaritjet vjetore të Popullsisë Banuese, kanë një përdorim të gjerë nga përdoruesit qofshin këta të qeverisë qendrore dhe lokale, të fushës akademike apo qoftë edhe përdorues të thjeshtë, kryesisht për planifikimin e politikave</p>

	<p>bazuar në evidenca sepse shifrat e popullsisë përdoren si emërues për llogaritjen e një sërë treguesisht social dhe ekonomik. Informacioni mbi nevojat e përdoruesve për, dhe perceptimet e tyre mbi përlllogaritjet e popullsisë matet në disa mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpeshtësinë e klikimit të produktit përkatës në web-sitin e INSTAT</li> <li>• Takime me përdorues të ndryshëm duke lejuar ata të diskutojnë mbi kërkesat dhe nevojat e tyre</li> <li>• Kontakte me përdorues të cilët kontaktojnë individualisht sektorin e Statistikave të Popullsisë mbi kërkesat e tyre specifike, apo dërgojnë në INSTAT këkesat e tyre lidhur me këto statistika</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Popullsinë për vitin 2019 janë rreth 84,859 klikime.</p> <p>Gjate 2019 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e statistikave të Popullsisë është vlerësuar me 3.63 (72.6%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon cdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë se Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Shkalla e plotshmërisë së të dhënave, për popullsinë 1 Janar 2020 në Shqipëri, është 80%. Eurostat lidhur më të dhënat për Popullsinë kërkon transmetimin e 15 treguesve, nga të cilët INSTAT prodhon 12 tregues.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Përlllogaritjet e popullsisë prodhohen duke u bazuar në një metodë demografike të mirë themeluar e quajtur, Metoda e Komponentit të Gjeneratës (referoju seksionit si është përgatitur produktimetodologjia). Kjo përfshin kombinimin e informacionit nga një sërë burim të dhënash duke përfshirë Censusin e fundit, të dhëna administrative dhe të dhëna nga anketa të ndryshme sociale. Burimet e të dhënave të përdorura janë më të mirat e mundshme në nivel kombëtar dhe rajonal (qarku), por përlllogaritjet janë subjekt i problemeve të mbulimit dhe gabimeve të lidhura me këto burime të dhënash. Informacioni nga regjistrat administrativë si numri i lindjeve dhe vdekjeve konsiderohen të jenë shumë të besueshme.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Një nga burimet potenciale të pasaktësisë së mundshme në përlllogaritjen e popullsisë banuese është përdorimi i anketave, në rastin tonë përdorimi i anketës së Forcave të Punës për matjen e migracionit ndërkombëtar. Problemet që mund të ketë me mbulimin dhe me azhornimin e kampionit kjo anketë (ku vazhdon të jetë Censusi i fundit si frame) mbarten edhe në përlllogaritjet tona.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Kontaktet telefonike përdoren nëse evidentohen gabime në procesin e raportimit. Përsa i përket të dhënave të lëvizjeve të brendshme, regjistrat administrativë janë të rëndësishëm për sigurimin e këtyre të dhënave. Saktësia dhe mbulimi i këtyre të dhënave ka ardhur duke u përmirësuar me kalimin e viteve. Megjithatë mbulimi akoma ka nevojë për përmirësim sepse jo të gjitha lëvizjet brenda vendit shoqërohen me</p>



	ndryshimin e vendbanimit në zyrat e gjendjes civile. Për përmirësimin në vazhdim të këtyre të dhënave projekti i ndërmarrë së fundmi nga Ministria e Brendshme për ndërtimin e regjistrit të adresave mund të jetë shumë i vlefshëm në këtë drejtim.
--	--

#### 14. Afatet kohore dhe përpikmëria

14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e “Popullsia e Shqipërisë” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 85 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 85 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Popullsia e Shqipërisë është 1 Janar 2020.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>1/1/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/26/2020</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>85</td> </tr> </table>	Periudha referuese	1/1/2020	Data e publikimit	3/26/2020	Afatet kohore	85
Periudha referuese	1/1/2020						
Data e publikimit	3/26/2020						
Afatet kohore	85						

14.2. Përpikmëria	<p>Zakonisht të dhënat e Popullsisë së Shqipërisë publikohen me përpikmeri bazuar në kalendarin e publikimeve. Këtë vit, publikimi i “Popullsia e Shqipërisë, Janar 2020” shtyhet me 44 ditë. Arsyeja e shtyrjes është pasi në datën 3/26/2020 INSTAT do të publikojë “Anketën e Migracionit” në Shqipëri e cila është një nga komponentët e lidhur drejtpërdrejtë me ndryshimin e popullsisë.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>1/1/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>2/11/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/26/2020</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>44</td> </tr> </table>	Periudha referuese	1/1/2020	Data e shpallur	2/11/2020	Data e publikimit	3/26/2020	Vonesa në kohë	44
Periudha referuese	1/1/2020								
Data e shpallur	2/11/2020								
Data e publikimit	3/26/2020								
Vonesa në kohë	44								

#### 15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Përlllogaritjet e popullsisë më 1 Janar disagregohen sipas ndarjes administrative të 12 qarqeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Berat</li> <li>2. Dibër</li> <li>3. Durrës</li> <li>4. Elbasan</li> <li>5. Fier</li> <li>6. Gjirokastrë</li> <li>7. Korçë</li> <li>8. Kukës</li> <li>9. Lezhë</li> <li>10. Shkodër</li> <li>11. Tiranë</li> <li>12. Vlorë.</li> </ol> <p>INSTAT përpilon dhe publikon përlllogaritje të popullsisë në nivel kombëtar dhe rajonal (qarqet). Kështu përlllogaritjet në nivel kombëtar dhe rajonal janë bazuar në të njëjtën metodologji llogaritjeje dhe kanë si qëllim të jenë sa më konsistente që të jetë e mundur.</p>
-----------------------------------	--

15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Trendet dhe disa nga indikatorët e strukturës së popullsisë për të dhënë një pamje më të qartë të ndryshimeve të kohore në përbërjen e Popullsisë Banuese të Shqipërisë analizohen dhe publikohen në botimin përkatës. Të dhëna shtesë</p>
------------------------------	---

	<p>përsa i përket komponentëve bazë të popullsisë si Lindje, Vdekje dhe Lëvizjet e brendshme të popullsisë, Migracioni dhe ndryshime të tjera, do të bëhen të mundshme për përdoruesit në fund të muajit Mars në web-sitin e INSTAT; dhe po ashtu në publikimet e Vjetarëve të parashikuar sipas kalendarit të botimeve, duke u shoqëruar më tej edhe me analizat përkatëse</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Kontrolle të rregullta të ndërthurura bëhen me informacione të marra nga burimet e të dhënave. Nëse implementohen ndryshime të rëndësishme në metodologji, INSTAT gjithashtu revizionon seritë e mëparshme të popullsisë që prej vitit të Censurit të mëparshëm. Kështu pas Censurit të vitit 2011, u krye një revizionim i serisë së përlllogaritjeve vjetore të popullsisë më 1 Janar që prej vitit 2002-2011. Metoda e përdorur për përlllogaritjen vjetore dhe rajonale të popullsisë për serinë 2002-2011 janë të disponueshme në web-sitin e INSTAT. Ndryshim tjetër i rëndësishëm në metodologji dhe cilësi të dhënash u krye për llogaritjen e popullsisë më 1 Janar 2017, nga e cila u pa e nevojshme revizionimi i serisë 2012-2017.</p>
15.4. Koherenca e brendshme	<p>Bëhen krahasime të vazhdueshme ndërmjet të dhënave nga burime të ndryshme. Përdoruesit shpesh krahasojnë përlllogaritjet e popullsisë banuese të kryera nga INSTAT me Popullsinë e shtetasve Shqiptar nga regjistri administrativ i Gjendjes Civile. Këto krahasime duhet të trajtohen me kujdes sepse midis tyre ka gjithmonë ndryshime në definicionet e përdorura. Ndonëse INSTAT llogarit popullsinë banuese duke ndjekur definicionin e Vendbanuesit të Zakonshëm pavarësisht shtetësisë, regjistri i gjendjes civile numëron të gjithë shtetasit Shqiptarë qofshin apo jo banues në Shqipëri në një moment të caktuar në kohë psh. 1 Janar.</p>
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Spektori i Statistikave të Popullsisë është pjesë e Drejtorisë së Statistikave Sociale. Staf i përfshirë në procedurat e mbledhjes së të dhënave, kontrollit të të dhënave, përditësimit dhe mirëmbajtjes së statistikave punon me kohë të plotë.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përgjegjës 1 të punësuar</li> <li>2. Specialistë 3 të punësuar</li> </ol> <p>Sa i përket të dhënave nga burimet administrative ato janë pa kosto. Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet INSTAT, Drejtërisë së Drejtorisë së Përgjithshme e Gjendjes Civile krijojnë mundësinë e transmetimit të të dhënave pa kosto.</p>
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të Statistikave të Popullsisë bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul>
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Përlllogaritjet e popullsisë u revizionuan për periudhën pas Censurit të fundit 2011, 2011-2017. Revizionimi u ndërmor si pasojë e ndryshimit të pjesshëm të metodologjisë së ndjekur, si dhe përmirësimit të disa prej të dhënave administrative të përdorura (lëvizjet e brendshme) ku u pa e nevojshme</p>

	<p>korrigjimi i tyre edhe për vitet e mëparshme për llogaritjen e popullsisë së qarqeve. Nga ana tjetër përfshirja në llogaritje e të dhënave të migracionit nga AFP për vitet 2015 dhe 2016, nxorri në pah nevojën e rishikimit të shifrave të imigracionit edhe për vitet e mëparshme. Përdorimi i metodës së komponentit të gjeneratës ka si doemosdoshmëri pikënisjen nga një popullsi e përlllogaritur saktësisht në mënyrë që të përftohen rezultate cilësore. Kështu rishikimi i serisë së të dhënave pas Censurit të fundit 2011 u pa si një doemosdoshmëri në mënyrë që të përftohet rezultate cilësore në përlllogaritjen e Popullsisë Banuese 1 Janar 2017.</p>
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Burimet kryesore të të dhënave mbi të cilën bazohen përlllogaritjet vjetore të popullsisë banuese janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lindjet dhe vdekjet e banuesve në Shqipëri nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile</li> <li>• Anketa e Tremujore të Forcave të Punës, nga e cila mundësohet një vlerësim për migracionin ndërkombëtar duke kombinuar këtë burim me Projeksionet e Popullsisë 2011-2031.</li> <li>• Lëvizjet e brendshme, të cilat janë të nevojshme për llogaritjen e popullsisë banuese në nivel qarku, mundësohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.</li> <li>• Anketa e Migracionit në Shqipëri</li> </ul>
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen çdo tre muaj/vit.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat për migracionin grumbullohen përmes Anketës Tremujore të Forcave të Punës dhe Anketës së Migracionit në Shqipëri. Pyetësi plotësohet përmes intervistimit të drejtpërdrejtë të individëve. Të dhëna administrative shumë të rëndësishme për sektorin e Popullsisë vihen në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Vleftësimi i të dhënave bëhet duke krahasuar të dhënat e vlerave aktuale apo me ato të një viti paraardhës.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Popullsia e Shqipërisë e llogaritur më 1 Janar 2020 bazohet në përlllogaritjen e kombinuar ndërmjet popullsisë më 1 Janar 2019 dhe ngjarjeve demografike (lindje dhe vdekje) që vijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe migracionit ndërkombëtar nga Anketa e Forcave të Punës.
18.6. Rregullimi	Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara.
<b>19. Komente</b>	
<b>Aneks</b>	

